KOMUNA E MAMUSHËS

# NJOFTIM PËR KONTRATË

☒ ***PUNË*** ☐ ***FURNIZIM*** ☐ ***SHËRBIME***

*Sipas Nenit 40të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092*

**Data e përgatitjes së njoftimit: 14.06.2024**

| | |
|---|---|
| **Nr i Prokurimit** | **626-24-5895-5-2-1** |
| **Nr i brendshëm** | |

Ky njoftim është përgatitur në GJUHËT:
Shqip ☒ Serbisht ☒ Anglisht ☐

## NENI I: AUTORITETI KONTRAKTUES

### I.1) EMRI DHE ADRESA E AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)

| | | |
|---|---|---|
| **Emri zyrtar**: **KOMUNA E MAMUSHËS** | | |
| **Adresa Postare**: **Rruga "Sahat Kulesi" nr. 44 Ndërtesa e Komunës së Mamushës** | | |
| Qyteti: **Mamushë** | Kodi postar: **20540** | Vendi: **Kosovë** |
| **Personi kontaktues**: **Gazmend Gashi** | | Telefoni: **03820045211** |
| Email: **mamusha.prokurimi@rks-gov.net** | | Faksi: |
| Adresa e Internetit (*nëse aplikohet)*: **http://kk.rks-gov.net/mamushe/** | | |

Po ☐ Jo ☒
Kontrata përshinë prokurimin e përbashkët

Po ☐ Jo ☒
Kontrata shpërblehet nga Agjencia Qendrore e Prokurimit

***Nëse po***, specifiko identitetin e të gjithë Autoriteteve Kontraktuese që kanë të drejtë të bëjnë porosi nën termet e kontratës ose referoju një Aneksi:

## NENI II: LËNDA E KONTRATËS

## II.1) PËRSHKRIMI

**II.1.1) Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues:**
**Ndërtimi dhe Asfaltimi i shtresës finale të rrugës Asker në Mamushë**

**II.1.2) Lloji i kontratës dhe lokacioni i punëve, vendi i dorëzimit apo realizimit**
*(Zgjidhni vetëm një kategori - punë, furnizime apo shërbime – e cila korrespondon më së shumti me objektin specifik të kontratës suaj)*

| ☒ Punë | ☐ Furnizime | ☐ Shërbime |
|---|---|---|
| ☒ Ekzekutim<br>☐ Plani dhe ekzekutimi<br>☐ Realizimi, në çfarëdo mënyre, të punës, përgjegjës me kërkesa | ☐ Blerja<br>☐ Qira financiare (lizing)<br>☐ Qira<br>☐ Blerje me këste<br>☐ Një kombinim i këtyre | |

Vendi apo vendndodhja kryesore e punëve/kryesor i dorëzimit/ kryesor i realizimit
**Punët do të ekzekutohen në Mamushë përgjatë rrugës Asker**

**II.1.3) Njoftimi përfshinë**

Krijimin e kontratës publike kornizë
☐

**II.1.4) Informacionet e marrëveshjes kornizë** *(nëse aplikohet):*

Kontrate publike kornizë me një operator
☐

Kontrate publike kornizë me disa operator
☐

**Ekzekutimi i kontratës:**

Thirrje/Porosi
☐

Kontrata ndihmëse/Mini-konkurencë
☐

**Kohëzgjatja e kontratës publike kornizë: në muaj**

**II.1.5) Përshkrim i shkurtër i lëndës së kontratës**
**Ky prokurim ka të bëjë me ndërtimin dhe asfaltimin e shtresës së dytë të rrugës "Asker" në Mamushë. Kontrata për këtë prokurim do të lidhet me operatorin ekonomik fitues të këtij tenderi, do të filloj të zbatohet menjëherë pas nënshkrimit të saj dhe do të ekzekutohet në bazë të planit dinamik për projektin në fjalë.**

**II.1.6) Klasifikimi i Fjalorit të Përgjithshëm të Prokurimit (FPP):**

**45233120-6**

**II.1.7) Variantet pranohen**

**Po** ☐ **Jo** ☒

**II.1.8) Ndarja në Pjesë**

**Po** ☐ **Jo** ☒

***Nëse po,*** tenderët mund të dorëzohen për *(shënoni vetëm një kuti)*

☐ vetëm një pjesë ☐ Të gjitha pjesët

**II.1.9) Informacione lidhur me pjesët** (*nëse aplikohen)*

| Nr. i pjesës | Emërtimi i grupit | Përshkrimi i shkurtër |
|---|---|---|
| | | |

**Numri maksimal i Pjesëveqë do të mund të shpërblehet tek një tenderues është:**

**II.1.10) Vlera e parashikuar e kontratës: 45,186.05**

## II.2) SASIA APO FUSHËVEPRIMI I KONTRATËS

**Sasia apo fushëveprimi i përgjithshëm** *(përfshirë të gjitha pjesët dhe opsionet nëse aplikohen)*
**Përmes kësaj kontrate do të bëhet shtrimi i shtresës së dytë të asfaltit në rrugën Asker e cila kap një gjatësi prej L = 500.00 m.**

## II.3) KOHËZGJATJA E KONTRATËS APO AFATET KOHORE PËR PËRFUNDIM

Kohëzgjatja në muaj apo ditë **30** (nga dhënia e kontratës)
*apo*
Fillimi
Përfundimi

## NENI III: INFORMACIONET LIGJORE, EKONOMIKE, FINANCIARE DHE TEKNIKE

## III.1) KUSHTET NË LIDHJE ME KONTRATËN

**III.1.1) Siguria e kërkuar e ekzekutimit**

**Po** ☒ **Jo** ☐

***Nëse po***, vlera e sigurisë së ekzekutimit EUR ose **10% e vlerës së kontratës për një vlefshmëri prej 60 ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës.** % e vlerës së kontratës

**III.1.2) Forma ligjore që do të merret përmes grupit të operatorëve ekonomik të cilëve do t`u jepet kontrata** *(nëse aplikohet)*:
**Forma ligjore që do të merret përmes grupit do të jetë forma e përcaktuar në nenin 11.1 të Seksionit**

| II. fleta e të dhënave të tenderit (FDT) |
|---|
| **III.1.3) Kushtet e tjera të veçanta me të cilat ka të bëjë ekzekutimi i kontratës**<br>**Po** ☒ **Jo** ☐<br><br>***Nëse po,*** përshkrimi i kushteve të veçanta<br>**-Operatorët ekonomik pjesëmarrës në këtë tender janë të obliguar që të hartojnë dhe me tenderin e tyre të dorëzojnë planin dinamik për ekzekutim të kontratës sipas sepecifikave teknike të kërkuara në dosjen e tenderit. - Plani dinamik nuk duhet të jetë më i gjatë se 30 (Tridhjetë) ditë pune nga data e marrjes së urdhër blerjes nga Autoriteti Kontraktues. Në rast të mos përmbushjes së këtij kushti O.E. do të konsiderohet si i pa përgjegjshëm, oferta do ti refuzohet dhe do të qojë në eliminimin e operatorit ekonomik.** |

## III.2) KUSHTET PËR PJESËMARRJE

| **III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë:** | *Dëshmia e kërkuar dokumentare:* |
|---|---|
| **1)Deklarata nën betim se Operatori Ekonomik i plotëson kushtet në bazë të nenit 65 Paragrafi 65.1 pikat 1.1; 1.2; 1.3 të LPP-s** | **1)Deklarata e shkruar nën Betim, e nënshkruar dhe e vulosur nga tenderuesi duke përdorur formën në Aneksin 2 të dosjes së tenderit.** |
| **2) Operatori Ekonomik nuk duhet të jetë në falimentim ose nën administrim te dhunshëm gjyqësorë pranë ndonjë Gjykate kompetente e vendit të themelimit të Operatorit Ekonomik.** | **2) Një vërtetim apo certifikatë origjinale (ose kopje e noterizuar) i lëshuar nga Gjykata kompetente. Vërtetimi kërkohet vetëm nga Operatori Ekonomik qe propozohet për dhënie të kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit të vendimit për dhënie të kontratës dhe nuk duhet te jete me i vjetër se 180 ditë nga data e lëshimit deri ne datën e publikimit të njoftimit për kontratë ose ftesës për ofertë.** |
| **3)Operatori ekonomik nuk duhet të jetë delikuent (shkelës) në pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit.** | **3) Vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik. Vërtetimi kërkohet vetëm nga Operatori Ekonomik qe propozohet për dhënie të kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit të vendimit për dhënie të kontratës dhe nuk duhet te jete me i vjetër se 90 ditë nga data e lëshimit deri ne datën e publikimit të njoftimit për kontratë ose ftesës për ofertë.** |
| **4) Operatori ekonomik, ndonjë drejtues, menaxher ose drejtor i saj nuk duhet të jetë i dënuar nga ndonjë gjykatë kompetente për kryerjen e ndonjë vepre penale ose civile duke përfshirë praktikat e korrupsionit, larjen e parave, dhënien e mitos dhe avantazheve gjatë dhjetë (10) viteve të kaluara.** | **4) Vërtetim nga sistemi qëndror i evidencës penale ose organi kompetent në vendin e themelimit të Operatorit Ekonomik.Vërtetimi kërkohet vetëm nga Operatori Ekonomik qe propozohet për dhënie të kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit të vendimit për dhënie të kontratës dhe nuk duhet te jete me i vjetër se 90 ditë nga data e lëshimit deri ne datën e publikimit të njoftimit për kontratë ose ftesës për ofertë.** |
| **III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:** | *Dëshmia e kërkuar dokumentare:* |
| **1. Regjistrimi i operatorit ekonomik në regjistrin përkatës profesional, të bizneseve dhe ose të korporatave.** | **1. Kopja e Certifikatës së biznesit së bashku me pjesët informative të biznesit.** |
| **2. Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të** | **2. Kopja e certifikatës së TVSH-së të** |

| | |
|---|---|
| jenë deklarues të TVSH-së | lëshuar nga Organi Kompetent |
| 3. Operatorë ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë regjistruar numrin fiskal në ATK | 3. Kopja e Certifikatës së regjistrimit të numrit fiskal (nëse nuk është e përfshirë në certifikatën e biznesit). |
| **III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar:** | *Dëshmia e kërkuar dokumentare:* |
| 1. Operatori ekonomik duhet t'i ofrojë dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik, gjatë tre viteve të fundit ka qenë prej jo më pak se 90,000.00 €.(nëntëdhjetëmijë Euro). | 1. Raportin,raportet apo vërtetimet përkatëse nga një ose më shumë banka ose deklaratat vjetore në ATK apo nga institucioni kompetent në vendin e themelimit të operatorit ekonomik me të cilat dëshmohet se O.E ka pasur një qarkullim financiar në tri vitet e fundit sipas kërkesës së lartshënuar. |
| **III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:** | *Dëshmia e kërkuar dokumentare:* |
| 1. Operatori ekonomik ose grupi i Operatoreve Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi së ka përfunduar me sukses projekte të njëjta në tri vitet e fundit nga data e njoftimit për kontrat në vlere prej 67,000.00 € (gjashtëdhjeteshtatëmijë euro) | 1. Lista e kontratave të realizuara (përfunduara) të natyrës së njëjta ( ndërtimi i kanalizimeve) në tri vitet e fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontratë, të bashkangjitura me kopje të referencave apo raporteve të pranimeve teknike në vlerën e kërkuar. |
| 2. OE duhet të kenë staf të mjaftueshëm të punëtorëve dhe inxhinierëve të kyçur në projekt, punëtor të rregullt ose me parakontratë nga të cilët minimumi 2.1 O.E. duhet të caktoj me vendim menaxherin e kontratës për këtë projekt i cili duhet të jetë inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë ose mastër të përfunduar (drejtimi konstruktiv) të ketë së paku 5 (pesë) vite përvojë pune. I certifikuar për siguri dhe shëndet në punë dhe i certifikuar për mbrojtje nga zjarri si dhe të jetë specialist për organizimin dhe menaxhimin e kantiereve të ndërtimit. 2.2 Një inxhinier të diplomuar ose bachelor të Arkitekturës, kërkohet të ketë min. 3(tre) vite përvojë pune pas diplomimit në angazhime profesionale. I certifikuar për siguri dhe shëndet në punë dhe i certifikuar për mbrojtje nga zjarri. 2.3 Një inxhinier të diplomuar ose master drejtimi Hidroteknik, kërkohet të ketë min. 5(pesë) vite përvojë pune pas diplomimit në angazhime profesionale. Të ketë menaxhuar së paku një projekt dhe të ofroj dëshmi për një menaxhim të tillë. I certifikuar për siguri dhe shëndet në punë dhe i certifikuar për mbrojtje nga zjarri. 2.4 Një inxhinier të diplomuar ose bachelor drejtimi Gjeodezi, i licencuar me licencë valide kërkohet të ketë min. 5(pesë) vite përvojë pune pas diplomimit në angazhime profesionale. 2.5 Një udhëheqës i punishtes teknik i ndërtimtarisë. I certifikuar për siguri dhe shëndet në punë dhe i certifikuar për mbrojtje nga zjarri. 2.6 Një ekspert të certifikuar për sistemet e drenazhimit. I certifikuar për siguri dhe shëndet në punë dhe i certifikuar për mbrojtje nga zjarri. 2.7. | 2. Lista origjinale e punëtorëve të O.E. nënshkruar dhe vulosur nga O.E. 2.1 Vendimi për caktimin e menaxherit të projektit (origjinal ose kopje e noterizuar) Diplomat, certifikatat e inxhinierit (kopje të noterizuara) Diplomat jashtë shtetit duhet të jenë të nostrifikuara. CV-ja e inxhinierëve duhet të jetë e nënshkruar nga inxhinieri (origjinal ose kopje e noterizuar). 2.2-2.3 Diplomat e noterizuara të inxhinierëve më së largu gjashtë (6) muaj para datës së publikimit të njoftimit të kontratës. CV-të e përshkruar qartë me eksperiencën e kërkuar të nënshkruar nga inxhinierët (origjinal ose kopje të noterizuara) 2.4 Për gjeodetin, diploma e noterizuar, jo më largë se gjashtë (6) muaj para datës së publikimit të njoftimit për kontratë, kontratën dhe CV-në të përshkruara qartë me përvojën e kërkuar të nënshkruar nga vetë inxhinieri (origjinal ose kopje e noterizuar) dhe një kopje të licencës. 2.5 Diploma e teknikut (kopje të noterizuar) CV-në të nënshkruar nga tekniku (origjinal ose kopje e noterizuar) 2.6 Kontratën dhe CV-në dhe një kopje të licencës. 2.7 Certifikatat e noterizuara jo më largë se gjashtë (6) muaj para datës së publikimit të njoftimit për kontratë. |

| | |
|---|---|
| Operatori Ekonomik duhet të ketë së paku 10 punëtorë të rregullt ose me parakontratë të certifikuar për siguri dhe shëndetë në punë dhe për mbrojtje nga zjarri. | |
| 3. Operatori Ekonomik duhet te posedoj mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit. Paisjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës në Aneksin 8 të DT. | 3. Dëshmi mbi pronësinë (apo marrëveshje te marrjes me qira ) të mjeteve, librezat e qarkullimit ose Deklaratat Unike Doganore ose faturat e blerjes për ato automjete që nuk kanë libreza të qarkullimit. Vëmendje! Në rast se OE nuk posedon pajisjet mbi pronësinë duhet te ofroj marrëveshjen për marrjen me qira te pajisjeve. Marrëveshja duhet të jetë në emër të këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga të dyja palët. Marrëveshja duhet te jetë e noterizuar me vërtetim nënshkrimi në mes të qiradhënësit dhe qiramarrësit. |
| 4. Raporti i vlerësimit të rriskut në vendet e punës, nga një kompani e licencuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ose ndonjë organ tjetër në vendin e themelimit të O.E. për siguri dhe shëndet në punë. | 4. Kopja e raportit të vlerësimit të rriskut në vendet e punës, kopja e licencës së kompanisë së licencuar për ushtrimin e punëve nga siguria dhe shëndeti në punë. Në rast të grupit, lideri duhet të ketë raportin e vlerësimit të rriskut. |
| 5. Operatori Ekonomik duhet të jetë i certifikuar me a. ISO 45001 2018 Sistemi i menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit në punë. b. ISO 9001 2015 Sistemi i menaxhimit të cilësisë. c. ISO 14001 2015 Sistemi i menaxhimit të mjedisit. d. ISO 39001 2012 Sistemi i menaxhimit të sigurisë në trafikun rrugor. | 5. Kopjet e noterizuara të certifikatave. Në rast të grupit lideri duhet të jetë i certifikuar me ISO-t e lartcekura |
| 6. Operatori Ekonomik duhet të posedojë bazën për prodhimin e asfaltit në pronësi apo marrëveshje për furnizim me asfalt (me të gjitha pajisjet) | 6. Kopja e licencës e vlefshme e lëshuar nga Agjencioni për Miniera dhe Minerale. Në rastet kur O.E. ka marrëveshje për furnizim, O.E. duhet të dorëzoj marrëveshjen e noterizuar te noteri me vërtetim nënshkrimi. |

## III.3) KUSHTET SPECIFIKE PËR KONTRATAT E SHËRBIMEVE

**Po** ☐ **Jo** ☐

**III.3.1)Ekzekutimi i shërbimeve i rezervuar për një profesion të caktuar**

*Nëse po,* referenca për ligjin, rregulloren apo dispozitën administrative përkatëse

**III.3.2 Personat ligjor duhet të tregojnë emrat e kualifikimeve profesionale të personelit përgjegjës për ekzekutimin e shërbimeve**

**Po** ☐ **Jo** ☐

## NENI IV: PROCEDURA

## IV.1) LLOJI I PROCEDURËS

| **IV.1.1) Lloji i procedurës** |
|---|
| ☒ **E hapur** |
| ☐ **E kufizuar** |
| ☐ **Konkurruese me negociata** |

☐ **Kuotim i Çmimit**

**IV.1.2)Kufizime në numrin e operatorëve të cilët do të ftohen për tenderim** *(procedurë e kufizuar apo konkurruese me negociata)*

Në bazë të aplikacioneve të pranuara, më së shumti 6 kandidat do të ftohen për të dorëzuar tenderët e detajuar të kësaj kontrate. Nëse më shumë se 6 kandidat të përshtatshëm i plotësojnë kriteret e mësipërme të përzgjedhjes, përparësitë dhe dobësitë relevante të aplikacioneve të këtyre kandidatëve do të ri-ekzaminohen për të identifikuar gjashtë aplikacionet më të mira për proceduren e tenderit. Të vetmit faktorë të cilët do të mirren parasysh gjatë këtij ri-ekzaminimi janë:

**IV.1.3) Reduktimi i numrit të operatorëve gjatë negociatave** *(procedurë konkurruese me negociata)*

Udhëheq negociatat në faza të njëpasnjëshme

**Po** ☐ **Jo** ☐

në mënyrë që të zvogëlohet numri i tenderëve të negociuar

Autoritetet kontraktuese mund të shpërblejnë
kontratat në bazë të tenderëve fillestarë pa negociata

**Po** ☐ **Jo** ☐

**IV.1.4 Numri minimal i kandidateve te cilët do te ftohen qe te dorëzojnë Tenderët fillestar është**:

**IV.1.5. Informata ne lidhje me ankandin elektronik**

Do te përdoret ankandi elektronik: Po ☐ Jo ☒

Informata shtese ne lidhje me ankandin elektronik:

## IV.2) KRITERET E DHËNIES

☒ **Çmimi më i ulët**

*ose*

☐ **Tenderi ekonomikisht më i favorshëm në drejtim të**

## IV.3) INFORMACIONET ADMINISTRATIVE

**IV.3.1) Publikimet paraprake në lidhje me kontratën e njëjtë**

**Po** ☐ **Jo** ☒

***Nëse po,***

Njoftim paraprak: i

Publikime tjera (*nëse aplikohen):*

i

i

| |
|---|
| **Po** ☐ **Jo** ☒<br>Dokumentet me pages<br><br>***Nëse po****,* çmimi EUR<br>Kushtet dhe metoda e pagesës: |
| **IV.3.2) Afati i fundit për pranim të *tenderëve / aplikacioneve:***<br><br>***data* 08.07.2024 *koha* 14:00:00 *vendi* Tenderët duhet të dorëzohen vetëm në formë elektronike përmes platformës elektronike të KRPP-s ne adresën e AK-s.** |
| **IV.3.3) Afati kohor për dorëzimin e *tenderëve / aplikacioneve* është shkurtuar:**<br>☐ **Po** ☒ **Jo**<br><br>***Nëse po****,* jep arsyetim |
| **IV.3.4)** A është e nevojshme siguria e tenderit:<br>**Po** ☒ **Jo** ☐<br><br>***Nëse po***, vlera e sigurisë së tenderit **1,000.00 €**<br>Vlefshmëria e sigurisë së tenderit në ditë **90** *apo* muaj |
| **IV.3.5) Periudha e vlefshmërisë së tenderit:**<br>Deri më: data: ditët **60** apo muajt |
| **IV.3.6) Takimi për hapjen e tenderëve:**<br><br>**data 08.07.2024 koha 14:00:00 vendi Objekti i Komunës së Mamushës-Zyra e prokurimit nr. 17** |

## NENI V: INFORMACIONET PLOTËSUESE

### V.1) ANKESAT

| |
|---|
| **Çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092ne adresën e specifikuar ne Nenin I te këtij Njoftimi për kontratë.** |

### V.2) INFORMACIONET SHTESË

| |
|---|
| **Shënim: operatorët ekonomik do të kenë të drejtë të dorëzojnë tenderin, kërkesën për pjesëmarrje dhe dokumentet e tjera të nevojshme apo dosjet të cilat u lejohen gjatë kryerjes së një aktiviteti të prokurimit në gjuhën Shqipe, Serbe dhe Angleze.**<br>*Shto informacione tjera: (si konferenca para-ofertuese, vizita ne punishte etj)* |